

Kart' e-tretë e apostollit Joan.

- 1 Unë plaku mbë Gaion' e-dashurë, të-cilin' un' e dua me të-vërtetë.
- 2 I-dashurë, për të-gjitha lutem të veç mbarë e të jesh shëndoshë, sikundrë vete
- 3 mbarë shpirti yt. Sepse ugëzuashë shumë, se vinjënë vëllezër edhe dëshmonjënë për të-vërtetënë t'ënde, sikundrë ti ecën ndë të-vërtetët. Nukë kam gëzim më të-math se këtë, të dëgjoni se djemt' e mi ecënjënë ndë të-vërtetët.
- 5 I-dashurë, punë të-vëjejturë për besëtar bën, çdo që u bën vëllezërvet e të-huajvet,
- 6 Të-cilëtë dëshmonjënë për dashurinë t'ënde përpara kishësë; të-cilëtë ndë i përcjellç sikundrë vëjen te Perëndia, mirë dotë bënjç.
- 7 Sepse për emërin' e ati dualinë, pa marrë
- 8 asgjë nga kombetë. Neve pra kemi detyrë të presëmë të-tillëtë *njerës*, që të bënemi bashkëpunëtorë ndë të-vërtetët.
- 9 I shkrova kishësë; po Dhiotrefi që do
- 10 të jetë i-parë ndër ata nukë na pret; Përandaj ndë arthça, dot' i kujtonj punërat' e ati që bën, dyke folurë me të-tepërë fjalë të-liga kundrë nesh; edhe sikur të mos i ishinë mjaft këto, as vetë nukë pret vëllezëritë, po edhe ata që duanë t'i *presënë* i nda-
- 11 lon, edhe nga kisha i nxjer jashtë. I-dashurë, mos ki për shëmbëllë të-ligënë, po të-

- mirënë. Ay që bën mirë, është nga Perëndia; po ay që bën keq, nuk' e ka parë Perëndinë.
- 12 Për Dhimitrin' epetë dëshmim i-mirë nga të-gjithë, edhe nga e-vërteta vetë; edhe neve dëshmojmë, edhe e dini se dëshmimi ynë është i-vërtetë.
- 13 Shumë kishnjam për të shkruarë, po nukë dua të të shkruanj me mellan e me pëndë;
- 14 Po shprenj për-së-çpejti të të shoh, edhe
- 15 dotë flasëmë gojë për gojë. Paqtimi *qoftë* mbë ty. Të falenë me shëndet miqtë. U fal me shëndet miqvet emërë mbë emërë.